

KOMISIONI I DISIPLINËS
VENDIM Nr. 3**Nr. 22 Prot.****11 Mars 2025**

Më datë **11 Mars 2025**, u mbledh **Komisioni i Disiplinës** i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, **z. Klevis Kaso**, me praninë e anëtarëve, **z. Ersi Oruci** dhe **z. Klaudio Ndoja**, për shqyrtimin e problematikës të ndodhur në ndeshjen e Kampionatit Kombëtar U18 Djem, Vllaznia vs Besëlidhja, e vlefshme për javën e XV-të, datë 9 mars 2025, në pallatin e sportit "Qazim Dervishi".

Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse, përfshirë relacionin e gjyqtarëve të ndeshjes, si dhe në bazë të **Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, **Komisioni i Disiplinës** vendosi:

1. **Sanksion financiar 50'000 lek ndaj shoqatës "Vllaznia"**, si dhe zhvillim i dy ndeshjeve të ardhshme pa spektatorë dhe humbje e ndeshjes afrofe për ekipin U18 djem (Vllaznia 0 – 20 Besëlidhja), në bazë të nenit 13.8, pika gj, të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit:
*"Hyrja e spektatorëve në fushën e lojës që çon në mosvijimin apo mosnisen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 50'000 lekë"*
2. **Përrjashtim me 6 muaj nga aktivitetet e FSHB-së për lojtarin Alen Elbasani.**

E Drejta për Ankimim

Sipas **nenit 11.8 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda **72 orëve** nga marrja e vendimit. Ankimi duhet të dorëzohet pranë **Komisionit të Apelit të FSHB-së** dhe të shoqërohet me vërtetimin e pagesës prej **10,000 lekësh** në arkën e FSHB-së.

Një kopje e kërkesës së ankimit i dërgohet palëve të përfshira. **Komisioni i Apelit** shqyrton çdo vendim të **Komisionit të Disiplinës** që kontestohet nga palët e interesuara.

Vendimet e **Komisionit të Apelit** mund të ankimohen pranë **Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS)**.

**Klevis Kaso**
Kryetar**Ersi Oruci**
Anëtar**Klaudio Ndoja**
Anëtar